

Vendim nr. 211, datë 25.06.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Asim Vokshi,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 25.06.2026 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 9 (S) 2026 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: SUZANA SHOTA, MARK SHOTA, përfaqësuar nga avokati Ervis Çela, me prokurë të përgjithshme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-248, datë 29.01.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Ndërmjet kërkuesve dhe shoqërisë “Banka NBG Albania” sh.a., sot (*Banka Amerikane e Investimeve, kredidhënësi*) është lidhur kontrata e kredisë bankare me nr. 3809 rep., nr. 970 kol., datë 08.10.2007 (*kontrata e kredisë bankare*), përmes së cilës kërkuesit kanë marrë kredi nga banka në shumën prej 144.000 eurosh, me një këst, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë. Si rrjedhojë e mospërbushjes nga kërkuesit të detyrimeve kontraktuale për shlyerjen e kredisë, kredidhënësi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit të kontratës së kredisë në fjalë (titull ekzekutiv). Gjykata e rrethit, me vendimin me nr. 3961 akti, datë 16.12.2010, ka vendosur pranimin e kërkesës, duke lëshuar urdhrin e ekzekutimit për titullin ekzekutiv, kontratën e kredisë bankare.

2. Në datë 26.08.2011, përmes shoqërisë përmbarimore “ARB” sh.p.k. (*shoqëria përmbarimore*), kredidhënësi ka iniciuar procedurat përmbarimore për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, në kuadër të të cilave, me shkresën nr. 1/28 prot., datë 07.09.2011, shoqëria përmbarimore fillimisht ka lajmëruar kërkuesit për ekzekutimin vullnetar të detyrimit kontraktor. Më pas, si rrjedhojë e moslikuidimit vullnetar të detyrimit nga kërkuesit, shoqëria përmbarimore ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm dhe ka disponuar me disa vendime për vënien e sekuestros konservative ndaj pasurive të tyre, përfshirë edhe të pasurive rrjedhojë e aksioneve ose interesat e tjera të kërkuesve mbi çdo shoqëri. Për këtë qëllim, me urdhrin nr. 9/28 prot., datë 01.02.2012, shoqëria përmbarimore i është drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) për vendosjen e sekuestros konservative ndaj shoqërisë tregtare “Comproser” sh.p.k., që, sipas ekstraktit të QKB-së, rezultonte në pronësi të kërkuesve, si ortakë të saj.

3. Nga ana tjetër, në kushtet që ndërmjet kreditorit dhe kërkuesve nuk ishte arritur një marrëveshje për përcaktimin e vlerës së sendeve të sekuestruara, shoqëria përmbarimore ka caktuar ekspert kontabël për vlerësimin e kuotave të shoqërisë “Comproser” sh.p.k., i cili, në datën 25.02.2014, ka përcaktuar vlerën e aseteve materiale e monetare të kësaj shoqërie në shumën 17.797.976 lekë.

4. Duke mos qenë dakord me vlerën e përcaktuar nga eksperti, shoqëria “Comproser” sh.p.k., me përfaqësuese ligjore kërkuesen Suzana Shota, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për kundërshtimin e këtij veprimi përmbarimor, ndërsa ka hequr më pas dorë nga kjo kërkesë, shkak për të cilin, me vendimin nr. 10104, datë 21.10.2014, gjykata e rrethit ka vendosur pushimin e gjykimit.

5. Në vijim, me vendimin nr. 29/28 prot., datë 01.04.2016, shoqëria përmbarimore ka vazhduar me procedurat për ekzekutimin e urdhrit të ekzekutimit, duke shpallur ankandin e parë për shitjen e kuotave të kërkuësve në shoqërinë "Comproser" sh.p.k. Ankandi është zhvilluar në datën 15.04.2016 dhe, sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim, është mbyllur pa ofertues. Në këtë situatë, shoqëria përmbarimore ka urdhëruar përsëritjen e ankandit për shitjen e kuotave të shoqërisë, duke shpallur, me shkresën nr. 35/28 prot., datë 25.04.2016, ankandin e dytë për këtë qëllim.

6. Vendimi nr. 29/28 prot., datë 01.04.2016 i zyrës përmbarimore për shpalljen e ankandit të parë për shitjen e kuotave të kërkuësve është kundërshtuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nga shoqëria "Comproser" sh.p.k., e cila, krahas përjashtimit nga sekuestrimi dhe shitja në ankand e aseteve të saj materiale dhe monetare, ka kërkuar edhe pezullimin e veprimeve të mëtejshme përmbarimore. Me vendimin nr. 4302, datë 23.05.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pranuar padinë, duke përjashtuar nga sekuestrimi dhe shitja në ankand asetet materiale dhe monetare të shoqërisë "Comproser" sh.p.k., sipas vendimit nr. 29/28 prot., datë 01.04.2016 të shoqërisë përmbarimore, si dhe pezullimin e veprimeve të mëtejshme përmbarimore për ekzekutimin e titullit ekzekutiv për këtë shoqëri, deri në përfundim të shqyrtimit të çështjes me vendim të formës së prerë. Mbi ankimet e kreditorit dhe të shoqërisë përmbarimore Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1791, datë 13.07.2017, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke rrëzuar kërkesëpadinë dhe duke hequr masën e pezullimit të veprimeve përmbarimore. Pas këtij vendimi shoqëria përmbarimore ka vijuar me veprimet e ekzekutimit në fazën e mbetur.

7. Me vendimin nr. 43/28 prot., datë 28.07.2017, shoqëria përmbarimore ka rishpallur ankandin për shitjen e kuotave të kërkuësve në pasurinë e luajtshme të shoqërisë "Comproser" SH.P.K., duke i përcaktuar ato në vlerën 12.814.542 lekë, pas uljes me 10 % të çmimit të ankandit të parë. Për këtë qëllim, ajo ka bërë njoftimin publik duke e botuar shpalljen e ankandit të dytë në dy gazeta kombëtare në datat 29, 30 e 31 korrik 2017, si dhe në datat 1 e 2 gusht 2017. Po kështu, nëpërmjet shërbimit postar ajo ka njoftuar për këtë: i) shoqërinë "Comproser" sh.p.k., në selinë e saj; ii) kërkuësen Suzana Shota, në banesën e saj, ku nga kthimi i njoftimeve, datë 31.07.2017, ka rezultuar shënimi: "*Nuk ka njeri, larguar me pushime*"; iii) QKB-në, njoftim i cili rezulton i protokolluar në datën 31.07.2017; iv) Bashkinë e Tiranës, ku kjo e fundit ka konfirmuar vendosjen e shpalljes në tabelën e lajmërimeve publike të informimit dhe të shërbimeve për qytetaret lidhur

me kërkuesit, si dhe publikimin e tij në faqen zyrtare elektronike të bashkisë; v) njësinë bashkiake nr. 7, ku kishin adresën kërkuesja dhe selinë shoqëria “Comproser” SH.P.K.

8. Pas realizimit të këtyre njoftimeve është zhvilluar ankandi i dytë dhe, referuar procesverbalit “Mbi zhvillimin e ankandit të dytë”, me nr. 49/28 prot., datë 02.08.2017, është shpallur fituesi për blerjen e kuotave të kërkuesve në shoqërinë “Comproser” SH.P.K., me ofertë të vetme dhe me çmim prej 12.815.542 lekësh, shtetasi L.Sh. Në këto kushte, pas kalimit të të gjithë shumës në llogari të shoqërisë përmbarimore, me aktin nr. 50/28 prot., datë 03.08.2017, është bërë kalimi në pronësi të blerësit i kuotave të kërkuesve në shoqërinë në fjalë, vendim i cili është regjistruar edhe në QKB.

9. Në datën 10.08.2017 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi për kundërshtimin/anulimin e veprimeve përmbarimore të shoqërisë së përmbarimit për: i) vendimin nr. 49/28 prot, datë 02.08.2017, për caktimin e vlerës së pasurisë për fillimin e procedurave të shitjes në ankandin e dytë; ii) procesverbalin për zhvillimin e ankandit nr. 49/28, datë 02.08.2017; iii) vendimin nr. 50/28 prot., datë 03.08.2017, për kalimin në pronësi të blerësit me ankand.

10. Me vendimin nr. 1861, datë 28.02.2018, gjykata e rrethit ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, sipas objektit. Ndër të tjera, kjo gjykatë ka argumentuar se gjatë gjykimit të çështjes ka rezultuar se akti i ekspertimit për vlerësimin e aseteve monetare dhe jomonetare të shoqërisë është hartuar më 25.02.2014, ndërsa procedura e shitjes në ankand është nisur më 28.07.2017, rreth tre vjet më vonë. Ky interval i gjatë kohor tregon se vlerësimi nuk pasqyron vlerën reale të pasurive në kohën e ankandit. Po sipas gjykatës, në rastin konkret, eksperti ka vlerësuar edhe një pasuri të paluajtshme të shoqërisë “Comproser” SH.P.K., sipas çmimit të blerjes së saj në vitin 2005, dhe jo sipas vlerës së tregut në momentin e shitjes. Në këto rrethana, vendimi i përmbaruesit i datës 28.07.2017, për përcaktimin e vlerës së pasurisë dhe fillimin e procedurës së ankandit të dytë, rezulton i pabazuar në ligj. Gjithashtu, nga aktet e administruara rezulton se ankandi i parë ishte mbyllur pa ofertues, më 15.04.2016, ndërsa procedurat përmbarimore kanë qenë të pezulluara deri më 13.07.2017. Për rrjedhojë, vendimi për caktimin e ankandit të dytë është marrë edhe jashtë afatit të parashikuar nga neni 557 i Kodit të Procedurës Civile (KPC). Për sa më sipër, gjykata e rrethit ka vlerësuar se vendimi i përmbaruesit gjyqësor, datë 28.07.2017 “Për caktimin e vlerës së pasurisë së luajtshme dhe fillimin e procedurave të shitjes në ankand (ankandi i dytë) është i

paligjshëm dhe, për rrjedhojë, janë të paligjshme edhe të gjitha veprimet përmbarimore të kryera në vijim të tij. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim kreditori dhe shoqëria përmbarimore.

11. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 246, datë 11.03.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1861, datë 28.02.2018, të gjykatës së rrethit dhe rrëzimin e padisë. Ajo gjykatë ka vlerësuar se për kërkimin e parë të objektit të kërkesëpadisë, për anulimin e veprimit përmbarimor për caktimin e vlerës së pasurisë për fillimin e procedurës së shitjes në ankand, datë 28.07.2017, padia është ngritur tej afatit ligjor 5-ditor. Sipas gjykatës së apelit, shoqëria përmbarimore kishte kryer njoftimin e debitorëve në përputhje me kërkesat procedurale, fillimisht në adresat e tyre të banimit dhe në selinë e shoqërisë, ndërsa pas njoftimit të tyre në këto adresa ka proceduar nëpërmjet shpalljes publike në QKB, Bashkinë e Tiranës dhe njësinë bashkiake nr. 7, njoftime që sipas konfirmimeve të datës 31.07.2017 rezultojnë se janë kryer. Nga dita që kërkuessit kanë marrë dijeni nëpërmjet njoftimit me shpallje deri në datën 10.08.2017, kur është depozituar kërkesëpadia, ka kaluar afati ligjor 5-ditor për kundërshtimin e këtij veprimi. Ndërsa për dy kërkimet e tjera lidhur me procesverbalin për zhvillimin e ankandit dhe vendimin për kalimin e pronësisë së blerësit, ka vlerësuar se secili nga veprimet përmbarimore është i kundërshtueshëm me vete, referuar nenit 610 të KPC-së, dhe për këto kërtime padia është paraqitur brenda afatit ligjor. Pavarësisht këtij konstatimi gjykata e apelit ka shqyrtuar edhe në themel pretendimet e kërkuessve lidhur me një vlerësim jo real të pasurisë, duke e konsideruar si të pabazuar atë, pasi vlera e pasurisë ishte përcaktuar nga eksperti në ankandin e parë, ndërsa në ankandin e dytë përmbaruesi ka zbatuar vetëm uljen 10% të parashikuar nga neni 557 i KPC-së. Sipas gjykatës së apelit, dispozitat procedurale parashikojnë afate të shkurtra brenda të cilave duhet të realizohet përsëritja e ankandit, por në rastin në gjykim këto afate janë shtyrë me vendim gjyqësor për pezullimin e veprimeve përmbarimore. Po kështu, nuk ekziston asnjë dispozitë ligjore që, për shkak të kalimit të kohës ose pezullimit të procedurës së përmbarimit me vendim gjyqësor, vlera e sendit në ankandin e dytë të përlllogaritej në një mënyrë tjetër nga ajo e parashikuar në nenin 557 të KPC-së. Sipas gjykatës së apelit, zhvillimi i ankandit të dytë në datën 28.07.2017 ishte bërë brenda afatit ligjor 10-ditor, të parashikuar në nenin 557 të KPC-së, pas vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, datë 13.07.2017, i cili kishte hequr pezullimin e veprimeve përmbarimore. Për sa i përket vendimit për kalimin e pronësisë në favor të blerësit, datë 03.08.2017, gjykata e apelit ka evidentuar se ai është marrë në përputhje me procedurat ligjore, pas shpalljes së fituesit dhe pagesës së plotë të çmimit, sipas nenit 574 të KPC-së.

12. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-248, datë 29.01.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesit, me arsyetimin se ishte bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të KPC-së. Sipas kolegjit, gjykata e apelit ka respektuar ligjin procedural dhe vendimi i dhënë prej saj nuk është në kundërshtim me ndonjë vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjeve të Bashkuara të saj.

13. Në datën 20.01.2026 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 20.04.2026.

II

Pretendimet e kërkuesve

14. **Kërkuesit**, më mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se iu është cenuar e drejta për *proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, duke parashtruar si shkaqe se vendimi i gjykatës së apelit është kontradiktor, pasi, nga njëra anë, pranon se kërkimi i tyre për kundërshtimin e caktimit të vlerës së pasurisë për fillimin e procedurave të shitjes në ankandin e dytë është paraqitur jashtë afatit ligjor 5 -ditor, nga ana tjetër, për dy kërkimet e tjera, procesverbalin për zhvillimin e ankandit dhe vendimin për kalimin në pronësi të blerësit, ka argumentuar se padia është paraqitur në afat, ndërkohë që disponimet janë bërë në të njëjtin vendim të përmbarduesit gjyqësor. Po kështu, ajo gjykatë ka argumentuar se padia është paraqitur jashtë afatit ligjor, ndërkohë që ka shqyrtuar në themel kërkimet e tyre. Gjykata e apelit nuk ka arsyetuar për mosrespektimin e afatit ligjor 5 ditor, sipas nenit 555 të KPC-së, për zhvillimin e ankandit të dytë. Nga njoftimet drejtuar QKB-së, Bashkisë së Tiranës dhe njësisë administrative, rezulton se ato janë protokolluar në datën 31.07.2017, ndërsa ankandi është zhvilluar në datën 02.08.2017. Gjykata e apelit, në mënyrë të gabuar, arsyeton se, meqenëse ligjvënësi nuk e ka parashikuar situatën sesi do të përcaktohet çmimi i sendit në ankandin e dytë, kur nga koha e zhvillimit të ankandit të parë ka kaluar një kohë e gjatë, atëherë domosdoshmërisht duhet që ankandi të vazhdojë me të njëjtin çmim të kuotave të përcaktuar nga eksperti më shumë se 3 vjet më parë. Në rastin konkret, duke qenë se kishin kaluar 3 vjet nga data e kryerjes së aktit të ekspertimi të vlerësimit të kuotave deri në datën e kryerjes së ankandit të dytë,

përmbaruesi gjyqësor duhet të kishte nisur procedurën e ekzekutimit nga e para duke urdhëruar kryerjen e një akti të ri ekspertimi, si dhe të anulonte ankandin e parë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkesës

15. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

16. Kriteret paraprake të legjitimitimit janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkesi të mos legjitimohet për shqyrtimin e ankimit kushtetues individual. Kolegji evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkesin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë, si pasojë, moskalimin e saj në seancë plenare.

17. Në rastin konkret, Kolegji çmon të ndalet në kriterin e legjitimitimit *ratione materiae*, në kuadër të të cilit Kolegji evidenton se, ndonëse objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor të iniciuar prej tyre, në përmbajtje të ankimit kushtetues individual kërkesit kanë ngritur pretendime ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë. Edhe pse formalisht kërkesit janë përfaqësuar nga avokat, në kërkesën drejtuar Gjykatës nuk kanë ngritur pretendime konkrete për shkelje të të drejtave dhe parimeve kushtetuese, por kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor. Në këtë situatë, duke mbajtur në konsideratë parimin *iura novit curia*, Kolegji vlerëson se

pretendimet e kërkuësve parashtrohen në thelb në kuadër të *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, të garantuar nga neni 142, pika 1, i Kushtetutës.

18. Në këndvështrim të këtij standardi, Kolegji vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuësit kanë pretenduar se vendimi i gjykatës së apelit është kontradiktor, pasi ajo gjykatë, nga njëra anë, pranon se kërkimi i tyre për kundërshtimin e veprimit për caktimin e vlerës së pasurisë për fillimin e procedurave të shitjes në ankandin e dytë është paraqitur jashtë afatit, ndërsa, nga ana tjetër, për dy kërkimet e tjera procesverbalin për zhvillimin e ankandit dhe vendimin për kalimin në pronësi të blerësit argumenton se padia është paraqitur në afat, ndërkohë, në rastin konkret, të dyja disponimet janë bërë në të njëjtin vendim të përmbartuesit gjyqësor. Po sipas tyre, gjykata e apelit arsyeton në mënyrë të gabuar se meqenëse ligjvënësi nuk e ka parashikuar situatën sesi do të përcaktohet çmimi i sendit në ankandin e dytë, kur nga koha e zhvillimit të ankandit të parë ka kaluar një kohë e gjatë, atëherë domosdoshmërisht duhet që ankandi të vazhdojë me të njëjtin çmim të kuotave të përcaktuar nga eksperti më shumë se 3 vjet më parë. Ata kanë pretenduar gjithashtu se edhe gjykata e apelit nuk ka arsyetuar për mosrespektimin e afatit 5-ditor sipas nenit 555 të KPC-së, për zhvillimin e ankandit të dytë.

19. Në jurisprudencën e saj në lidhje me standardin e arsytimit të vendimeve gjyqësore, Gjykata ka theksuar se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë dhe duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 63, datë 23.09.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret, Kolegji vëren se gjykata e apelit, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet për ankim të kërkuësve, ka vlerësuar se kërkitimi për anulimin e veprimit përmbartimor për caktimin e vlerës së pasurisë për fillimin e procedurës së shitjes në ankand, datë 28.07.2017, është paraqitur jashtë afatit ligjor 5-ditor, të parashikuar nga ligji. Ndërsa për kërkitimet që lidhen me anulimin e procesverbalit të ankandit dhe vendimit për kalimin e pronësisë, duke vlerësuar se secili veprim përmbartimor është një veprim i kundërshtueshëm më vete, referuar nenit 610 të KPC-së, për këto kërkitime padia është paraqitur brenda afatit ligjor. Sipas gjykatës, vlera e pasurisë është përcaktuar në përputhje me ligjin, pasi në ankandin e dytë është aplikuar vetëm ulja 10% e vlerës së pasurisë sipas parashikimit të nenit 557 të KPC-së. Gjithashtu, sipas gjykatës së apelit, pezullimi i procedurës përmbartimore me vendim gjyqësor nuk e detyronte përmbartuesin gjyqësor që të bënte rivlerësimin e pasurisë. Ankandi i dytë është zhvilluar brenda afatit ligjor pas heqjes së pezullimit me vendim gjyqësor të formës së prerë, ndërsa vendimi për kalimin e pronësisë është marrë në përputhje me nenin 574 të KPC-së, pas pagesës së plotë të çmimit nga blerësi (*shih sipër paragrafin 13 të këtij vendimi*).

21. Për rekursin e kërkuësit Gjykata e Lartë ka vlerësuar se është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të KPC-së. Sipas kolegjit, gjykata e apelit ka respektuar ligjin procedural dhe se vendimi i dhënë prej saj nuk është në kundërshtim me ndonjë vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjeve të Bashkuara të saj.

22. Për sa më lart, Kolegji, duke iu referuar arsytimit të gjykatës së apelit dhe atij të Gjykatës së Lartë, çmon se ato i përmbushin elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe u kanë dhënë përgjigje shtetuese pretendimeve të ngritura nga kërkuësit. Vendimet përmbajnë të dhënat e palëve, shkaqet e parashtruara në ankim/rekurs, vendimet e gjykatave më të ulëta, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku kanë mbështetur qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Kolegji çmon se arsyetimi i gjykatës së apelit për ngritjen tej afatit ligjor 5-ditor të padisë për anulimin e veprimit përmbartimor për caktimin e vlerës së pasurisë për fillimin e procedurës së shitjes në ankand, datë 28.07.2017, si dhe secili nga veprimet përmbartimore është një veprim i kundërshtueshëm më vete, referuar nenit 610 të KPC-së, në këndvështrimin kushtetues nuk rezulton arbitrar. Ashtu siç ajo gjykatë ka arsyetuar, në rastin konkret evidentohet se njoftimi kërkuësve për këtë veprim iu është bërë po në atë datë nëpërmjet shërbimit postar në adresën e tyre dhe më pas me shpallje, njoftime këto që sipas konfirmimeve, datë 31.07.2017, rezultojnë të realizuara, ndërsa padia është paraqitur në datën 10.08.2017, pra

jashtë afatit 5-ditor për kundërshtimin e këtij veprimi. Ndërsa Kolegji e vlerëson si të drejtë konkluzionin e gjykatës së apelit se zhvillimi i ankandit të dytë, datë 28.07.2017, ishte bërë brenda afatit ligjor 10-ditor, të parashikuar në nenin 557 të KPC-së, pas vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, datë 13.07.2017, i cili kishte hequr pezullimin e veprimeve përmbartimore. Po kështu, vlera e pasurisë është përcaktuar në përputhje me parashikimet e nenit 557 të KPC-së, pasi në ankandin e dytë është aplikuar ulja 10% e vlerës së pasurisë. Nëse do të ndiqej arsyetimi i kërkuarit se procesi përmbartimor ose veprime të caktuara brenda tij, duhej të fillonte nga e para sa herë që kalon kohë për shkak të ankimeve të palëve ndaj fazave të ndryshme të këtij procesi, atëherë kjo do të dëmtonte vetë thelbin e kësaj faze të procesit të rregullt ligjor, që synon vendosjen në vend të së drejtës.

23. Në vlerësimin e Kolegjit, vendimet nuk rezultojnë të jenë alogjike, kontradiktore ose të paqarta në përmbajtjen dhe vlerësimin e tyre. Për sa kohë nga kërkuarit nuk argumentohet se zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme ka qenë eventalisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë, të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës, vetëm fakti se në përfundim të procesit gjyqësor, në të cilin palët kanë pasur mundësinë të ushtrojnë garancitë e tyre procedurale, gjykatat kanë dhënë një vendim jo në favor të tyre, nuk është i mjaftueshëm për të provuar cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

24. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuarve nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.